



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:064891

Datë: 28.04.2022

Numri i dokumentit: 02962157

P.nr.102/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit N. G. fsh. G. K. Lipjan, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.716/22, të datës 28.02.2022, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhërit ndëshkimor, jashtë seances gjyqesore me datën 05.04.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.716/22, të datës 28.02.2022, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

N.G., i biri i K., i lindur me *data e lindjes...*nga fshati G. K.Lipjan, me numër personal *numri...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me pare i padenuar, mbrohet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Me dt. 27.10.2021 në lokalën e tij, në fshatin Gillogoc K.Lipjan, punëtorët e KEDS-it, gjatë një kontrollë tek i pandehuri me nr. unik DPR 9037916, kanë konstatuar se i njejtë, me qëllim që vetit t'i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka anashkaluar njëhisorin elektrik duke i lidhur jashtë pikës matëse, me c'rast energjia e shpenzuar nuk është matur fare, me cka të dëmtuarës KEDS-it i ka shkaktuar dëm pasuror në vlerë prej 223.04 -€.

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së si dhe nenit 365 dhe 495 të KPPK-së, të pandehurit i gjykon me,

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 100.-€, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, me dënim me burgim ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

Detyrohet i pandehuri që të dëmtuarës KEDS Distriktit Ferizaj tia kompenzoj dëmin material në shumë prej 223.04.-€ në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën nga 20.-€, në llogarinë e kësaj gjykate, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30.-€, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.716/22, të datës 28.02.2022, e ka akuzuar të pandehurin N. G. nga fsh .G. K.Lipjan, për shkak të veprës penale Vjedhja e sherbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së , dhe në të njëjtën datë ka kërkuar që të pandehureve t’iu shqiptohet urdhër ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjykata duke analizuar aktakuzën, si dhe kallëzimin penal me numër të rastit CMS-K/DFE-26 te dt.27.01.2022,fatura për rikthimin e humbjeve, kalkulimii rikthimit të humbjeve, procesverbali i mbajtur nga KEDS, foto të njehesorit, si dhe shkresave tjera të lëndës konsideroi se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor ndaj të akuzuarit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 1 (një) vit, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.1. dhe nën par. 2.6 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u bazua në nenin 39 par. 1 pika 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasuroro-juridike u bazua në nenin 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN

P.nr. 102/22 me dt.05.04.2022.

Sekretarja Juridike
Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:064891
Datë: 28.04.2022
Numri i dokumentit: 02962157